



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 42-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 11.09.2025, në sallën numër 2 kati i 3-të, në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Shahadije Bikliqi-Dragaçina, anëtare
4. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Zoran Cirkovic, anëtar
7. Slavisa Trajkovic, anëtar
8. Olga Gucic, anëtare

Të tjerë prezent

1. Brahim Duriqi nga DKA
2. Përfaqësues të OSBE-së dhe UNMIK-ut
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e 41-të
2. Informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit shkollor
3. Të ndryshme

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës dhe pas votimit Komiteti me 8 vota për e votoi rendin e ditës.

Pastaj u kalua në pikën e parë të rendit të ditës.

Aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja 41-të e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje apo plotësime të ekstraktit nga mbledhja 41-të e Komitetit për Komunitete?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht aprovoi të njëjtin.

Kryesuesi, Skender Bikliqi, tha se po vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, derisa të vjen dikush nga DKA-ja.

III

Të ndryshme

Slavisa Trajkovic, tha se, unë ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin që kemi pas po ashtu, ne si Komitet jemi munduar të bëjmë më të mirën e Komitetit.

Zoran Cirkovic, tha se edhe unë si parafolësi i falënderoj për kontributin dhe bashkëpunimin, e në veçanti anëtarët e Kuvendit që i kanë ngritur kërkesat tona në Kuvend.

Lumuriye Bytyqi-Hasani, tha se edhe unë ju falënderoj për bashkëpunimin të gjithëve e në veçanti Naserin dhe Beharin të cilët kanë qënë shumë bashkëpunues.

Shahadije Dragaçina, tha se, edhe unë ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin.

Gentinë Hoxhaj, tha se, sikurse prafolësit edhe unë falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin.

Skender Bikliqi, kryesues i Komitetit, tha se ne si Komitet kemi pas bashkëpunim shumë të mirë mes veti dhe ju falënderoj për bashkëpunimin që kemi pas. Një falënderim të veçant e kam për zyrtarët e sektorit të Kuvendit, Naserin dhe Beharin të cilët çdo herë na kanë mbështetur dhe na kanë ndihmuar dhe asnjëherë nuk kanë përtuar.

Pastaj u kalua në pikën në vazhdim.

II

Informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit shkollor

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Brahim Duriqit nga DKA, i cili njoftoi në pika të shkurtra për fillimin e vitit shkollor 2025-2026.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se kam dy pyetje, e para, a keni informata se a janë paisur të gjithë nxënësit me libra dhe e dyta, kur pritet të hapet shkolla e re, mbrapa shkollës Adem Gllavica.

Shahaadije Dragaçina, tha se kam një pyetje nga qytetarët, pse në shkollën fillore Vëllezërit Frashëri, fëmijët parafillor fillojnë mësimin në orën 9:00 e jo në orën 8:00, pasi që kjo po ju shkakton probleme qytetarëve.

Brahim Duriqi, tha se, sa i përket librave ka telashe të disa fëmijë, por kjo është çështje e Ministrisë, siq është edhe ajo e shkollës. Ndërsa sa i përket orarit të parashkollorëve është çështje e shkollës se si vendos.

Pasi diskutime tjera nuk pati, kryesuesi i Komitetit, Skender Bikliqi tha se, pasi që është mbledhja e fundit, ju uroj sukses atyre që janë garë dhe çdo të mirë.

Mbledhja përfundoi në ora 13⁵⁰.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi